



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME PLENARE TË KUVENDIT
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 7 MAJ 2014**

**SA VANREDNE PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE
KOSOVA, ODRŽANE 07. MAJA 2014. GODINE**

**MAJ - MAJ
2014**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit të deputetëve për shpërndarjen e Legjislaturës IV të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Dnevni red

1. Razmatranje zahteva Grupe poslanika o raspuštanju četvrtog saziva Skupštine Republike Kosova

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës së jashtëzakonshme, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare, me kërkesë të Grupit prej 57 deputetëve të Kuvendit të Kosovës, me një pikë të rendit të ditës:

1. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit të deputetëve për shpërndarjen e Legjislaturës IV të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Konstatoj se në sallë janë 108 deputetë me prani fizike. Ju kisha lutur që ta tregojmë edhe praninë elektronike.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me kartela i kemi 114, kështu janë lajmëruar 113. Pra, kemi kuorum të mjaftueshëm. 114 e kemi praninë fizike.

E ftoj Arsim Bajramin, që në emër të Grupit të deputetëve, para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë propozimin.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar të propozoj që mbi bazën e nenit 82, pika 2 e Kushtetutës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës ta shqyrtojë mocionin për shpërndarjen e Parlamentit të Kosovës.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet këtë mocion me përgjegjësinë që ka si mazhorancë për ta ruajtur funksionalitetin kushtetues të Kuvendit të Kosovës dhe stabilitetin e përgjithshëm institucional të institucioneve të Republikës së Kosovës.

Ne jemi të vetëdijshëm që Kuvendi i Republikës së Kosovës gjatë gjithë mandatit duhet të jetë funksional brenda funksioneve kushtetuese dhe kërkojmë si grup parlamentar mbështetjen e të gjitha partive politike që të...

KRYETARI: A po flet në emër të Grupit të 57 deputetëve, apo në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike?

ARSIM BAJRAMI: Po flas në emër të Grupit të 57 deputetëve. Ne kërkojmë që të gjitha partitë politike ta mbështetin këtë mocion për ta hapur rrugën për zgjedhjet e parakohshme dhe për ta realizuar marrëveshjen politike të shumicës së liderëve të partive

politike, në mënyrë që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme për të krijuar parakushte demokratike dhe të lira për mbajtjen e zgjedhjeve të lira me standarde ndërkombëtare.

Ne kërkojmë që të gjitha institucionet kushtetuese të veprojnë mbi bazën e këtij mocioni dhe Republika e Kosovës të përgatitet me të gjitha kapacitetet e saj që ka për të mbajtur zgjedhje të lira dhe me standarde ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Partisë Demokratike, e do fjalën dikush. Kryetari i Grupit, Adem Grabovci e ka fjalën. Le të lajmërohen kryetarët e grupeve parlamentare.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e mbështet nismën e deputetëve nënshkrues për shpërbërjen e Parlamentit të Kosovës dhe hapjen e rrugës për zgjedhje të lira demokratike në nivel nacional. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kryetari i Grupit Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kërkesë disamujore e LDK-së ka qenë që të shkohet në zgjedhje më herët dhe atë në qershor. Për ne si Lidhje Demokratike e Kosovës është shumë e rëndësishme, nëse vendos, e besoj ky Kuvend do të vendosë të hapë rrugë për zgjedhje, sepse për ne jo shumë e rëndësishme është forma se sa përmbajtja dhe esenca, dhe esenca e gjithë kësaj është që të shkohet në zgjedhje dhe qytetarët me votën e tyre kësaj Qeverie, që sot qenka komplet, t'ia tregojnë derën për në shtëpi dhe ne besojmë shumë që kjo do të ndodhë.

Grupi Parlamentar i LDK-së sigurisht do ta votojë këtë mocion, pjesë e të cilit edhe është. Edhe një herë po e them - është ngjarje e veçantë, sepse po mundësohet që qytetarët ta thonë fjalën e tyre në zgjedhjet që na presin. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit të “Vetëvendosjes”, kryetari i Grupit, Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Më 6 prill të vitit 2011, pas një periudhe disamujore të kundërshtimit të një procesi jashtëzakonisht të manipuluar zgjedhor, LDK-ja u dorëzua. Si lider që e quante veten opozitar, Isa Mustafa iu nënshtrua vullnetit të Hashim Thaçit, kryeministrit të votave të vjedhura, duke e arritur një marrëveshje jashtë institucioneve dhe kundërkushtetuese me të.

Rezultati i kësaj marrëveshjeje tashmë dihet: presidentja doli nga zarfi, Thaçi mbeti kryeministër me gjithë votat e vjedhura, u themeluan dy komisione ad hoc parlamentare, të cilat vetëm sa konsumuan kohë, para dhe energji kot. E si pasojë e këtij flirti të Mustafës me Thaçin: Thaçi bëri koncesione jashtëzakonisht të dëmshme dhe afatgjata

ndaj Serbisë, u pranua themelimi i një entiteti serb brenda Kosovës ngjashëm si në Bosnjë, u krijua një buxhet i ndarë për këtë entitet, u amnistuan kriminelët serbë të strukturave paralele, u derdhën mbi 700 milionë euro në llogarinë e 'Behtel&Enka'-s, iu fal i tërë rrjeti i Shpërndarjes së energjisë elektrike të Kosovës konsorciumit 'Limak&Çalik', u vodhën shumë miliona nga buxheti i shtetit, përfshirë këtu 1,4 milionët nga Ministria e Punëve të Brendshme, ndërhyrja ilegale e Serbisë brenda Kosovës në gjyqësi, polici, energji, telekomunikacion e administratë u legalizua dhe u formalizua, Kosovës iu hoq emërtimi 'republikë', ndërkohë që republika degradoi për së brendshmi - u krijua Gjykata e Veçantë për Krimet e Luftës për pjesëtarët e UÇK-së.

Këto nuk do të ndodhnin po të mos i pranonin ato dhe partitë opozitare. Për shembull, kur ne u bëmë bashkë, e kaluam mocionin e reciprocitetit me Serbinë, duke insistuar kështu që Kosova ta marrë pozitën e barabartë karshi ish-okupatorit. Kur ne qëndruam të vendosur bashkë e parandaluam plaçkitjen e radhës që po i përgatitej pasurisë publike të Kosovës nëpërmjet privatizimit të PTK-së. Dy herë me radhë ia kthyem prapa Qeverisë ligjin për pensionet, atë për investimet e huaja, e kthyem Ligjin për Prizrenin herën e parë, për institucionet mikrofinanciare e tjerë.

I miratuam komisionet hetimore për faturat e KEDS-it, për privatizimin e PTK-së, për privatizimin e Fabrikës së Amortizatorëve, për privatizimin e 'Ballkanit' të Therandës.

Sa herë që vepruam të vendosur si deputetë, në mbrojtje të interesit të përgjithshëm shtetëror, Kuvendi triumfoi kundër dëmeve që na vinin nga Qeveria. Por, fatkeqësisht, këto raste vinin duke u rralluar, sepse flirti fillestar vinte duke u rritur.

Dhe u kurorëzua, për çudinë e shumëkujt për Shën Valentin, në Ditën e të Dashuruarve, më 14 shkurt 2014. Atë ditë Thaçi e Mustafa u morën vesh që ta shpërbëjnë Kuvendin. Shpërbërja e Kuvendit e fajëson Kuvendin, sikur degradimi politik, ekonomik e social i vendit të kishte qenë pasojë e këtij Kuvendit, duke e amnistuar kështu plotësisht Qeverinë.

Ne jemi këmbëngulës që faji për këtë gjendje në Kosovë bie mbi Qeverinë, dhe mbi ata deputetë të Kuvendit, të cilët kanë shërbyer si vegël e saj, e që fatkeqësisht nuk ishin vetëm të koalicionit qeverisës.

Rruga drejt zgjedhjeve duhet të jetë ajo e rrëzimit të Qeverisë. Dhe, në këtë rrëzim të Qeverisë të jetë njëkohësisht edhe kundërshtim i politikave të saj, e jo vetëm i njerëzve në të. Ndryshimi në Kosovë vjen nëpërmjet ndëshkimit politik të Qeverisë dhe politikave qeveritare, si dhe nëpërmjet ndëshkimit gjyqësor të zyrtarëve të korruptuar.

Një mocion mosbesimi për Qeverinë duhet domosdoshmërisht ta përmbajë kundërshtimin e marrëveshjes, negociatave dhe koncesioneve ndaj Serbisë, si dhe kundërshtimin ndaj politikave qeveritare të rrënimit të pasurisë publike, të keqpërdorimit të parasë publike, të politikave varfëruese dhe kundër zhvillimore të Qeverisë. Përndryshe, çfarëdo metode tjetër vetëm sa e përforcon këtë keqqeverisje.

Ne duhet ta ndëshkojmë Qeverinë dhe politikat e kësaj qeverie. Lëvizja “Vetëvendosje” e ka kërkuar këtë që prej 4 dhjetorit të vitit 2011. I tërë ky degradim i ekonomisë, rrënim i shtetit, e varfërim i popullit, ka mundur të ndalet. Dhe, është i ndalshëm. Por, ju nuk e deshët këtë rrugë. Ju zgjodhët rrugën tjetër. E zgjodhët rrugën e bashkëpunimit me Thaçin.

Dhe, tash pafytyrësisht e kërkon votën tonë për këtë marrëveshje, për marrëveshjen me Thaçin, dhe atë me një nismë të PDK-së, e cila dëshmohej të jetë nismë e PDK-së edhe nga pozicioni i nënshkrimeve në të, por edhe nga personi që e shpalli atë dhe foli në emër të deputetëve, pra deputeti i koalicionit ose i Partisë Demokratike të Kosovës.

Ne nuk bëhemi pjesë e kësaj marrëveshjeje. Kosova nuk ndryshon duke u marrë vesh me Thaçin. Kjo është dëshmuar në koalicionin para këtij mandati që e keni pasur me të. Kjo është dëshmuar edhe gjatë këtyre viteve të këtij mandati, të marrëveshjeve jashtinstitucionale e jo transparente që i keni bërë me të.

Kjo po dëshmohej edhe sot me këtë ndëshkim që po përgatiteni t’ia bëni Kuvendit dhe me këtë shfaqësim që po ia bëni Qeverisë, gjithnjë në marrëveshje me Thaçin. Faleminderit!

KRYETARI: Ismet Beqiri ka kërkuar replikë.

ISMET BEQIRI: Zoti kryetar!

Unë i them zotit Ymeri që e ka ngatërruar adresën, se pozitë është PDK-ja, por kur i konvenon, ky duhet treguar se në Prishtinë bashkë paskan flirtuar dhe kanë flirtuar me PDK-në, dhe i kanë fituar zgjedhjet. Këtë e di i gjithë opinioni. Arsyeja pse ne dëshirojmë të ndryshojë kjo gjendje, është që të shkohet në zgjedhje dhe Kuvendi, përkatësisht qytetarët janë ata që do të vendosin. Edhe në herë po e përsërisë, pak ka rëndësi forma. Është e rëndësishme të shkohet në zgjedhje.

Kush po dëshiron t’ia zgjasë jetën kësaj Qeverie, se kërkosh nuk ia kërkoi votën, po shihet kush është. Jeni ju atëherë, sepse kjo është formë, se nuk shkon vetëm Kuvendi, shkon edhe Qeveria në shtëpi. Dhe, ndëshkimin e bëjnë qytetarët, nuk e bëni as ju, as ne këtu. Fatkeqësisht që nuk kemi mundur ta bëjmë më herët, por edhe kjo nuk është vonë dhe është shumë fat i madh për qytetarët nëse arrijmë të rezultojë me shpërbërje të këtij Kuvendi dhe të shkojmë në zgjedhje dhe pastaj do të matemi e t’i mbajmë ligjëratat njëri-tjetrit. Sa u përket flirteve, ky është vend i vogël, secili e di kush me kë po flirton.

KRYETARI: Një minutë, Visar!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Është shumë e qartë që LDK-ja tash ndihet në siklet për shkak të flirit, sepse ky flirt fatkeqësisht, ose fatmirësisht për Kosovën, më mirë të them, u bë publik edhe po shihet. Sa i përket Prishtinës, konsideroj se ato që i thotë zoti Beqiri nuk duhet fare të merren parasysh, sepse më së miri e dëshmon qeverisja në Prishtinë, e veçanërisht përndjekja e të korruptuarve të LDK-së brenda kësaj komune që e ka degraduar gjendjen në kryeqytetin

e Kosovës. Ndërkohë që marrëveshjet me Thaçin është shumë e qartë se kush i ka bërë dhe kush po i bën dhe është shumë e qartë se kush po përgatitet t'i bëjë. Pra, është LDK-ja ajo që vazhdimisht takohet me Thaçin, e Thaçi vazhdimisht me Daçiqin. Mendoj se kjo nuk do koment.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kryetari Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI. Faleminderit, zoti kryetar i Kuvendit!

Zoti kryeministër në largim,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Mocioni i përbashkët i dy partive që e kemi para vetes, me të vërtetë e sjell deri në fund edhe Qeverinë e Kosovës me shkarkimin e Kuvendit. Në demokraci parlamentare, shkon edhe Qeveria, është e vërtetë. Por, mendoj se Kosova, qytetarët e saj, edhe Kuvendi, edhe deputetët, kanë merituar ta kenë një qeveri të shkarkuar, e jo një Kuvend të shpërbërë. Edhe është mëkat pse një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Më 13 shkurt të këtij viti, ne kemi kërkuar mocion. Nuk është mbështetur nga dy partitë opozitare dhe sot dëgjojmë këtu dikush që thotë duhet të shkarkohet Qeveria. Po nëse duhet të shkarkohet Qeveria, pse nuk na i dhatë nënshkrimet për t'u shkarkua Qeveria? Domethënë është lehtë të ketë vetëm fjalë - të flitet, të flitet, e të flitet - e kur të vijë puna, të mos bëhet ajo punë.

Sidoqoftë, pas më shumë se tre vjetësh të kësaj legjislature duhet treguar diçka se çfarë ka ndodhur, se si është Kosova sot, t'ia bëjmë një auditim, një prerje ku gjendemi. E vërteta është që Kosova është shteti më i izoluar në Evropë. Është e vërtetë. Kosova dhe qytetarët e saj janë më të izoluarit në Evropë. Me gjithë faktin se para dy vjetëve është marrë udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave, pak gjë ka ndodhur në Kosovë. Dikush mund të thotë në Qeveri se nuk është faji veç yni. Hajt po pajtohemi që faji nuk është vetëm i Qeverisë, por atëherë pse u keni thënë njerëzve para 7 vjetëve që do të ketë liberalizim të vizave për një vit. Edhe para tre vjetëve prapë për 6 muaj dhe nuk është duke ndodhur kurrë. Tash prapë do t'u thoni do të ketë për një vit liberalizim të vizave, por si ia keni nisur nuk do të ndodhë. Percepcioni ndërkombëtar për shtetin e Kosovës është më i keq i mundshmi.

Vendi ynë shihet si vend i krimit, i korrupsionit, i moszhvillimit ekonomik, i njerëzve që duan të dalin me anije, me trena, të ikën prej këtu, i reklamave në televizion me njerëz që flejnë nën ura, i një qeverisjeje të keqe, i një vendi ku askush nuk dëshiron të vijë të investojë, i një vendi ku kompanitë refuzojnë të na shesin mall. E kam përmendur disa herë, nuk e di a ka gjë më të rëndë se një kompani komerciale të thotë nuk dua as të të shes ty mall për shkak të korrupsionit.

Kosova është vendi më i varfër në Evropë, gati gjysma e popullsisë është e papunë. Askush nuk do të bëjë biznes dhe nuk mund të bëjë biznes pa dhënë ryshfet. Nuk mund ta nisë biznesin pa dhënë ryshfet. Shkollat janë të ftohta dhe të papastra. Kur po i përmendi këto, kujtojini pak premtimet e para tre vjetëve dhe të para 7 vjetëve.

Në klinika, që po dëgjojmë që janë të mira, mungojnë barnat, mungon ngrohja, tualetet janë me fekalë. Kështu janë klinikat tona. Për shkak të korrupsionit, rrugët që nuk janë ndërtuar, që sapo janë ndërtuar, duhet të ndërtohen edhe një herë. Prishen menjëherë.

Kosova është vendi më i pasur në botë me minerale, me xehe për kokë banori, e ne importojmë edhe gozhda. Nëse nuk e keni ditë, Kosova importon gozhda. Kjo është Kosova e pas 7 vjetëve të qeverisjes aktuale. Para 7 vjetëve është premtuar 'luginë e silikonit' në Kosovë. A e dini sa njerëz punësohen brenda vitit në Kosovë? 7 000. A e dini pse punësohen 7 000? Se numri i njëjtë i njerëzve del në pension, e një 20 000 mbeten pa punë, për çdo vit i shtohen tregut të të papunëve.

24 orë rrymë ka qenë premtimi në vitin 2007 dhe 24 orë ka qenë prapë premtimi në vitin 2010. Dhe, edhe sot në Kuvendin e Kosovës punon gjeneratori, e lëre më në zonat rurale. Gjeneratorët punojnë edhe sot e kësaj dite. Është premtuar që do të ketë ujë 24 orë ujë. Prej Qeverisë është premtuar, edhe në 2007 edhe në vitin 2010. Jeni duke parë si i ka të paktën Prishtina punë me ujë. Është premtuar zero korrupsion. Motoja e fushatës së zotit Thaçi në vitin 2007 ka qenë zero korrupsion. Jo vetëm që nuk është përmbushur ky premtim, por Kosova i ka tejkaluar të gjitha parametrat me të cilët matet korrupsioni. A e dini se kur korrupsioni bëhet aq i madh, nuk ka as si ta matësh më. Kanë hequr dorë njerëzit, kjo është arritur.

Para tre vjetëve, pak më shumë se para 3 vjetëve, Qeveria është bërë bashkë dhe ka shkuar në Banjsko dhe na kanë thënë ne këtu, përpara edhe popullit të Kosovës, 'deri tash e kemi bërë shtetin, prej tash është koha e zhvillimit ekonomik'.

Të nderuar deputetët të Kuvendit të Kosovës,

Asnjë gjë që e kanë premtuar nuk e kanë bërë. Ama asnjë send të vetëm që mund të përmendet. Ua ka rritur rrogat njerëzve dy herë, dy muaj para zgjedhjeve. Gjatë gjithë kohës së mandatit as nuk lodhen për ta. Tash dy herë, si të ofrohen zgjedhjet, ua rritin rrogat. Njerëzit e Kosovës nuk janë krejt pa mend. E fundit për këtë temë, para se të kthehem pak te Kuvendi, është se dikush ka thënë që qeveritë në Kosovë nuk po i kryejnë mandatet kurrë. Është e pavërtetë. Qeveria e parë, prej vitit 2001-2004 e ka kryer mandatin e plotë, Qeveria e dytë prej 2004-2007 e ka kryer mandatin e plotë. Janë vetëm qeveritë e zotit Thaçi që asnjëherë nuk po arrijnë ta kryejnë mandatin deri në fund. Ta këqyrim çfarë po ndodhë më pastaj.

Tani dua të kthehem pak te Kuvendi, çka e ka karakterizuar Kuvendin dhe po dua të kem kujdes të mos debat, kujdes të cilin e kemi pasur si Aleancë deri tash, por të mos karakterizojë një luftë e partive në opozitë, po praktikisht në Kuvendin e Kosovës, sidomos prej Lëvizjes "Vetëvendosje", çfarëdo diskutimi ka filluar me kritika ndaj opozitës. Jo ndaj partisë në pushtet! Ju e keni kritikuar partinë në pushtet, por i keni nisur diskutimet me kritika ndaj opozitës. Tani, a ka qenë ky misioni për t'i bërë të tjerët në opozitë të duken sa më keq që të jetë e mundshme, e ju të dukeni sa më mirë që të jetë e mundshme, tregoni vetë, por kështu nuk shkojnë disa çështje. Nuk mund të kërkonim përmbledhje të opozitës, punë të opozitës, kur vazhdimisht, edhe në televizion, edhe në

Kuvend, e nisni duke thënë sa të këqij janë këta të tjerët, e sa të mirë jemi ne. Është pakëz fëmijërore kjo punë.

Nuk mund të ketë veprim politik duke shkukur mikrofonta e duke bërë diçka tjetër. Nuk është veprim politik ai. Çështja tjetër që po dua ta them në këtë drejtim është edhe një herë - mos thoni duam ta shkarkojmë Qeverinë, e kur ta sjellim mocionin të mos i vini nënshkrimet. Zoti Visar Ymeri, nuk mund të thuash këtu ne jemi kundër shpërbërjes, jemi për shkarkim të Qeverisë, ndërsa e ke pasur mocionin përpara e nuk e ke nënshkruar. Si fjali e fundit për dy partitë në opozitë, unë e kam me vete listën e mocionit, kërkoj 10 minuta pauzë prej kryetarit të Kuvendit, vetëm 10 minuta pauzë, sillini nënshkrimet në mocion, nuk po e shpërbëjmë Kuvendin, por po e shkarkojmë Qeverinë e Kosovës, sepse e meriton. Është kërkesë zyrtare 10 minuta pauzë për t'i marrë nënshkrimet për mocion mosbesimi për Qeverinë, nëse jeni të gatshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, deputetja Myzejene Selmani e ka fjalën. Ju lutem, jemi në seancë të jashtëzakonshme me të vetmen pikë të rendit të ditës dhe ju lutem që ta respektoni. Nuk ka mocion më sot!

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Përshëndetje për Qeverinë dhe deputetët,

Duke e parë këtë mocion, i cili na është ofruar sot dhe duke e parë arsyetimin, i cili e arsyeton shpërbërjen e Kuvendit të Kosovës, ku thuhet se duke u bazuar në marrëveshjen e arritur të liderëve të partive politike, mund të them sinqerisht se duke marrë parasysh marrëveshjen e arritur ndërmjet PDK-së dhe LDK-së, jo ndërmjet liderëve të partive politike, ju lutem, nënshkrimet janë të PDK-së dhe të LDK-së...

(Ndërhyrje)

Të lutem, mbylle gojën kur të flas unë!

...dhe, duke marrë parasysh se të dy subjektet e mëdha politike hedhin arsyetim në çështje me marrëveshjen, cila marrëveshje me partitë politike? Ju lutem! A në hajgare e keni kthyer Kuvendin e Kosovës? Në rast se e marrim qeverisjen katërvjeçare të Thaçit 2, mund të themi se komplet Qeveria Thaçi ka punuar me projektet e Qeverisë PDK-LDK dhe me të gjitha bordet PDK-LDK. Dhe, në rast se mendoni se hyni në zgjedhje, në cilat zgjedhje - të fabrikimit të votës industriale siç kanë qenë në vitin 2010? Në përgatitjen e komisionarëve dhe vëzhguesve jashtë territorit të Kosovës për manipulim të votave? Jo! Më vjen keq!

Kosova nuk i meriton edhe një herë zgjedhjet e vitit 2010 dhe në rast se lideri i partisë më të madhe këtu dhe lideri i opozitës, i cili jep nënshkrimet dhe nuk është këtu, garanton se këto zgjedhje do të jenë fer e demokratike dhe do të pranohen nga të gjithë faktorët ndërkombëtarë, atëherë mund të bisedohet, por siç jeni duke vepruar sot koalicioni PDK-LDK jo. Më vjen keq! Unë nuk mund të luaj me autoritetin e qytetarëve të Kosovës.

Interesat e dy subjekteve politike janë interesa mbimadhore të qytetarëve të Kosovës.

KRYETARI: Në emër të SLS-së, Petar Miletqi e ka fjalën.

PETAR MILETIĆ: Hvala predsedniče skupštine,

Poštovani predsedniče Vlade,

Članovi Vlade,

Koleginice i kolege poslanici,

U ime Poslaničke grupe Samostalne liberalne stranke, želim da vam kažem da mi nismo najsrećniji ovakvim raspletom situacije. Međutim, smatram i to je stav naše poslaničke grupe da nefunkcionalna skupština kakva je ona danas, nije u interesu nikoga.

Zašto smo mi nezadovoljni, ima jedan najvažniji razlog, ima ih više, ali ovaj je najvažnije. Dakle, pitanje rezervisanih mesta u ovoj Skupštini nije rešeno, i pitanje rezervisanih mesta je dovođeno u kontekst sa mnogo drugim temama. Međutim, ukoliko danas bude ova Skupština raspuštena, nevećinske zajednice će ostati bez ovih rezervisanih mesta. Mi time nismo zadovoljni, i mislimo da ovo nije rešeno na adekvatan način.

Mediji su u zadnje vreme često spekulisali da su ova rezervisana mesta čak povezana i sa transformacijom iz kosovskih bezbednosne snaga u oružane bezbednosne snage, što nije istina, dakle mi već mesec dana ne učestvujemo u radu plenarnih sednica isključivo iz razloga što smo hteli da skrenemo pažnju na ovaj problem.

Međutim današnjim eventualnim raspuštanjem Skupštine ovo poglavlje će biti završeno, i mi smo naravno time nezadovoljni, međutim s druge strane mi poslanici srpske zajednica pre svega poslanička grupa koju pripadam smo ponosni na ono što smo uradili u tokom ovog mandat.

Pre svega mislim na potpisivanje briselskog sporazuma između premijera Kosova gospodina Tacija i premijera gospodina Dačića, smatramo da smo dali naš doprinos da do ovog sporazuma dođe, i smatram da je ovo jedan od najvažniji poslova koji su završeni u ovom mandatu.

Ostalo je naravno da ovaj sporazum bude implementiran do kraja, i ne samo ovaj sporazum, nego jedan hroničan problem Kosova da svi sporazumi koji se postignu ne budu implementirani do kraja, a ja ću da vas podsetiti na neke, podsetiću vas na neke sporazume koje su postigli Edita Tahiri i Borko Stefanović, podsetiću vas na neke odredbe iz Ahtisarijevog plana koje su ugrađeni u zakone u ove Skupštine a ne poštuju se dovoljno, pre svega mislim o zakonu o istorijskom centru Prizrena, zakon o selu Velika Hoća i još nekim delovima Ahtsarijevog plana koji još uvek nisu ispoštovati do kraja, međutim kao poslanik u drugom sazivu ove Skupštine sam ponosan na to što smo ipak mi kao poslanici završili ove poslove uspešno, i zakon o Velikoj Hoći i o Prezrenu i Zakon o RTK-a, i Zakon o verskim slobodama sve su to zakoni koji treba da štite ne većinske zajednice u ovom slučaju srpsku zajednicu koju pripadam.

Pošto vidim da je pred izborna kampanja već počela želim da svima poželim sreću na ovim izborima želim da se svi ponašamo fer, demokratski da ovi izbori budu na

demokratskim principima i da građani Kosova dobiju onako vlast kakvu zaslužuju. Hvala.

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, kryetarja Mufera Shinik e ka fjalën.

MÜFERA ŞİNİK: Teşekkür ederim!

Sayın Başkan, Başbakan, Bakanlar ve Değerli Milletvekilleri

“6+” Parlamenter Gurubunu oluşturan Türk, Boşnak ve Rom milletvekilleri olarak, Meclis çalışmalarında her zaman Kosova için ve toplumumuz için önemli yasaların onaylanmasında destek sunduğumuz gibi, Kosova vatandaşlarının çıkarları doğrultusunda daha iyi bir Kosova için Meclisin gelecekte daha da verimli olması için “6+” Parlamenter Gurubu olarak Kosova Cumhuriyeti Meclisinin feshedilmesi önerisini destekliyoruz. Şimdiden herkese hayırlı seçimler diliyoruz.

Teşekkür ederim!

KRYETARI: Radha është nëse dëshiron ta marrë fjalën Kabineti qeveritar. Kryeministri e kërkoj fjalën, por nuk është këtu. Vazhdojmë, i kemi gjashtë deputetë të lajmëruar. Për replikë atëherë po ia jep deputetit Visar Ymeri. Dy minuta!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Kjo është replikë natyrisht se ndaj asaj që e tha zoti Gjini, sepse mu përmend emri edhe iu referua drejtpërsëdrejti edhe “Vetëvendosjes”, qëndrimin të “Vetëvendosjes”.

“Vetëvendosja” kurrë nuk ka thënë edhe kjo mendoj që është një keqpërdorim me thënë ashtu i qëndrimin të “Vetëvendosjes” se “Vetëvendosja” është më e mira. Ne kurrë nuk kemi thënë kështu. Natyrisht se ne qëndrimet tona politike i kemi të ndryshme prej partive tjera dhe nëse zotit Gjini i mbetet merak t’i ketë qëndrimet si tonat, mund t’i ndryshojë, nëse i duken më të mira, por sidoqoftë nëse nuk do, është çështje e tij. Por, për ta shkurtuar këtë se nuk po dua të replikoj shumë, po zoti Gjini ne jemi për ta rrëzuar Qeverinë edhe jemi për t’u bërë bashkë edhe ta rrëzojmë Qeverinë. Hajde, po takohemi të tri subjektet bashkë edhe po e nënshkruajmë mocionin për mosbesim edhe po e qesim në Kuvend.

Ne kemi qenë për këtë prej vitit 2011, jemi vazhdimisht për këtë edhe ju kemi thënë që jemi të gatshëm që të ulemi e ta diskutojmë mocionin e mosbesimit. Ju më keni thënë, ti dhe zoti Ismet Beqiri po e provojmë njëherë shpërbërjen e Kuvendit edhe tash po e provoni shpërbërjen e Kuvendit. Pra, faji është te ju pse keni pritur deri tash jo te ne. Faleminderit!

KRYETARI: Ardiani s’është, Daut ti do replikë? Urdhëro, një minutë!

DAUT HARADINAJ: Kryetar, se iu referua subjektit njëjtë është. Edhe njëherë po them edhe si procedurë mundemi të shkojmë 10 minuta në pauzë, shefat e grupeve parlamentare opozitare le të merren vesh, në rast se janë të gatshëm për shkarkimin e Qeverisë e kanë në tavolinë, e propozoj Ardian Gjini, gjithçka është e qartë.

KRYETARI: Nëse është vullneti i kryetarëve të grupeve parlamentare... Urdhëro kryeministër, e ke fjalën.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit!

I nderuar kryetar Krasniqi!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar dhe shumë të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Zonja dhe zotërinj,

Sot jemi mbledhur në këtë seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, për të marrë një vendim të përbashkët në interes të vendit dhe qytetarëve tanë. Ashtu siç edhe jeni të informuar të gjithë ne, pra siç jemi të informuar, në muajt e fundit, sidomos në javët e fundit ne si liderë institucional dhe udhëheqës të partive politike, kemi zhvilluar takime dhe konsulta të shumta që ndërlidhen me çështje të rëndësishme për vendin tonë.

Tanimë ne jemi pajtuar që të shkojmë në një proces të koordinuar edhe për hapat e mëtejshëm të organizimit të zgjedhjeve të parakohshme.

Partia që e udhëheq unë, Partia Demokratike e Kosovës, ka marrë një vendim të merituar në interes të ruajtjes dhe forcimit të unitetit dhe bashkëpunimit ndërpartiak në interes të vendit tonë. Vlerësoj se çdo parti që i është bashkangjitur këtij vullneti që e kemi diskutuar edhe më herët, jo veç vullnetit të Partisë Demokratike të Kosovës, ka marrë vendimin më të drejtë të mundshëm.

Prandaj, kemi edhe listën e deputetëve iniciues të Partisë Demokratike, të LDK-së, partive tjera që ky Kuvend sot të marrë vendim për shpërbërje dhe të hapë rrugën ligjore për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.

Unë konsideroj se një vendim i tillë i cili po bëhet në mënyrë të koordinuar ndërmjet forcave kryesore politike të Kosovës, është i domosdoshëm në këtë fazë. Argumentet pse duhet marrë një vendim i tillë janë disa: po më lejoni t'i them vetëm ato më të rëndësishmet.

Vendimi për shpërbërje të këtij Kuvendi po bëhet në pajtueshmëri të plotë të partive kryesore në vend, prandaj, mendoj që është momenti i duhur që të organizojmë zgjedhjet e lira të një kualiteti të lartë me qëllim që edhe institucionet që krijohen të jenë kredibile, funksionale.

Argumenti tjetër ndërlidhet me vendimin që javë më parë është marrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për themelimin e Forcave të Armatosura të Kosovës, ushtrisë së Kosovës.

Ky vendim është marrë pas përfundimit të suksesshëm të procesit të rishikimit të sektorit të sigurisë së Kosovës, i cili është bërë në koordinim të ngushtë me partnerët tanë ndërkombëtar. Qeveria e Republikës së Kosovës, në afat optimal po ashtu ka proceduar

ndryshimet kushtetuese dhe ligjore në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, e cila po ashtu ka dhënë vendim pozitiv.

Në ndërkohë, Kuvendi i Kosovës nuk i ka dhënë përgjigje adekuate vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pra me mosvotim apo që nuk kanë qenë ende në procedurë, formimet e komunave si është komuna në Rugovë të Hasit, në Gjonaj të Hasit, rajonin e Rugovës së Pejës, Komoran, Reçan, Zhegër etj.

Duhet ta kuptojmë se Kosova duhet të ketë institucione kredibile që marrin vendime në interes të shtetit dhe qytetarëve të vetë.

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Tani është detyrë thelbësore e Komisionit Qendror Zgjedhor dhe gjitha institucioneve shtetërore të Kosovës, që të sigurojnë mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në përputhje me standardet më të larta demokratike.

Në zgjedhjet e fundit lokale ne kemi vendosur një standard të lartë të mbajtjes së zgjedhjeve të lira në vend. Qeveria e Kosovës do t'i kryejë të gjitha obligimet në mbështetje të plotë të KQZ-së që të kemi sukses të plotë në këto zgjedhje. Prandaj, duhet të sigurohemi që edhe këto zgjedhje të parakohshme, të cilat gjithashtu po mbahen në përputhje me ligjin dhe Kushtetutën e Kosovës dhe brenda afateve kohore të përcaktuara me ligj të jenë mirë të organizuara, transparente dhe rezultatet të pranohen dhe respektohen nga gjithë subjektet pjesëmarrëse.

Natyrisht, ne do të përkujdesemi që të kemi misione të shumta vëzhguese ndërkombëtare që e kanë konfirmuar edhe pjesëmarrjen, në veçanti të Bashkimit Evropian, por edhe vëzhgues vendorë me qëllim që të sigurohemi për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor. Ne kemi zhvilluar si lider politikë konsulta dhe jemi dakorduar. Në fund më lejoni, të nderuar deputetë, të falënderoj secilin nga ju për përkrahjen dhe kritikën tuaj të vazhdueshme.

Përkrahja juaj na ka mundësuar që të marrim vendime të mira në interes të vendit dhe qytetarëve, ndërsa edhe kritikën e juaj të vazhdueshme na kanë shërbyer si motivim për të përmirësuar qeverisjen në vend.

Dua t'i falënderoj të gjitha partitë e koalicionit qeverisës për punën e madhe që kemi bërë bashkarish, mendoj që puna e bërë do të shërbejë si argument primar për të dalë ballë para qytetarëve të Kosovës. Gjithashtu dua t'i falënderoj partitë opozitare të kësaj legjislature në mënyrë të veçantë Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, Lidhjen Demokratike të Kosovës, për rolin e tyre konstruktiv-opozitar dhe mbështetjen e vazhdueshme të agjendës së interesit nacional.

Ka qenë privilegj për mua që si kryeministër të punoj bashkë me ju në të gjitha çështjet e interesit nacional. Nuk kam asnjë dyshim se kështu do të jetë edhe në të ardhmen në qeverisjen e ardhshme. Në fund dua t'i falënderoj të gjithë qytetarët e Kosovës për

mundësinë që na kanë dhënë për t'i shërbyer atyre dhe interesave të shtetit tonë, si do të vazhdojmë t'i shërbejmë edhe në të ardhmen.

Ndihma dhe përkrahja juaj, qytetarë të Kosovës, ka qenë vendimtare për suksesin tonë. Ne bashkarish kemi arritur suksesin, jam i sigurt se kështu do të jetë edhe në të ardhmen. Faleminderit, shumë të nderuar deputetë, faleminderit shumë të nderuar qytetarë të Kosovës! Faleminderit prej mysafirëve...

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Para se ta vazhdojmë debatin dua t'u njoftoj pse nuk mund të renditet kërkesa e Grupit të Aleancës.

Në nenin 100 të Kushtetutës për mocionin që është e njëjta gjë edhe në Rregulloren e Punës së Kuvendit, neni 31, neni 100, pika 3 shkruan: “mocioni i mosbesimit vihet në rend të ditës të Kuvendit jo më vonë se pesë ditë e as më herët se dy ditë nga dita e parashtrimit të tij”. Të njëjtën gjë e ka edhe Rregullorja, neni 30, pika 3: “mocioni i mosbesimit vihet në rend të ditës jo më vonë se pesë ditë dhe jo më herët se dy ditë nga dita e parashtrimit të tij”.

Prandaj, ajo sot nuk mund të vihet.

Atëherë, unë i thërras shefat dhe shefat ta prezantojnë qëndrimin e grupeve të tyre. Në emër të Partisë Demokratike, Adem Grabovci e ka fjalën.

Të nderuar deputetë,
Ne pauzën edhe mund ta marrim, por në rend të ditës ajo çështje s'mund të hyjë. Ajo çështje mund të hyjë vetëm ju nëse nuk jeni dakord ta votoni me 2/3 e rendit të ditës që e kemi sot.

Prandaj, ne vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!
Sot mendoj që tash edhe kjo pjesa e debatit të fundit, e mira është që për Kuvendin edhe qytetarët e vendit është se kryeministri Hashim Thaçi për herë të fundit mendoj edhe në karrierën e tij politike, po i drejtohet deputetëve si kryeministër.

E unë mendoj se miqve të idealit dhe ideologjisë së Hashimit mund edhe nja 2-3 ditë t'ia zgjatni këtë mundësi, por mendoj se po e zgjatni një regjim i cili do të ndëshkohet nga qytetarët e vendit me votën e tyre në qershor.

Po e theksoj shkurt, në qershor ashtu siç është muaji i qershisë, qytetarëve të vendit do t'ju kthehet buzëqeshja dhe mbi të gjitha, dinjiteti. Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit.)

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Albin Kurti.

ALBIN KURTI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Së pari, në këtë arsyetim thuhet që marrëveshja e arritur të liderëve të partive politike.

Nga deputetja Myzejene Selmani ne e kuptuam që nuk po dihet të cilëve liderë. Pra, sot u vërtetua që Kuvendi ka mungesë informacioni, për shkak të mungesës së transparencës. Pra, ne nuk e dimë me cilët liderë është kjo marrëveshje dhe për më tepër nuk e kemi marrëveshjen e shkruar.

Ne duhet ta dimë çka përmban kjo marrëveshje, për të cilën po votohet sot.

Fakti që disa liderë e nuk po dihet sa janë marrë vesh, nuk e garanton që ne ta dimë se çfarë përmban ajo marrëveshja. Pra, cili është teksti i kësaj marrëveshjeje, ne kemi nevojë ta dimë, por gjëra të tjera janë shumë më thelbësore.

Kryeministri i Kosovës duhet të japë dorëheqje. Kryeministri e ka premtuar ushtrinë për Kosovën, nuk e realizoi premtimin. Meqenëse nuk e realizoi premtimin, rendi moral edhe institucional i gjërave thotë që kryeministri duhet të japë dorëheqje. E nëse, kryeministri nuk është as institucional dhe është jo moral, atëherë rendi politik i gjërave thotë që opozita duhet ta rrëzojë Qeverinë.

Kryeministri pra, s'po jep dorëheqje, i takon opozitës që ta rrëzojë Qeverinë. Kuvendi, pra, sot e ka shansin që të merret vesh për rrëzimin e Qeverisë dhe jo të lejojmë që Qeveria ta rrëzojë Kuvendin.

Ju e dini që si deputetë të Kuvendit të Kosovës vazhdimisht jemi ankuar që Qeveria po e shpërfill Kuvendin, vazhdimisht, edhe në komisionet parlamentare. Dhe, si po kurorëzohet mandati i këtij kuvendi tash, jo me rrëzimin e Qeverisë, po me shpërbërjen e Kuvendit.

Ankesat e vazhdueshme të deputetëve opozitarë për shpërfilljen që na e ka bërë Qeveria, nuk duhet t'i kurorëzojmë me shpërbërjen apo shpërndarjen e Kuvendit të Republikës.

Kuvendi i Kosovës, ju e dini që i ka buxhet veç 10 milionë euro. Qeveria këtu prapa meje, menaxhon me buxhetin e shtetit që është 1 miliard e gjysmë euro. Kur ata që i kanë 10 milionë euro e rrëzojnë atë që i ka 1 miliard e gjysmë euro, kjo është demokraci. Kur ata që i kanë 1 miliardë e gjysmë euro i rrëzojnë ata që i ka 10 milionë euro, ky është biznes. Pra, biznesi thotë që Qeveria me 1 miliard e gjysmë na rrëzon neve me 10 milionë, ndërkaq demokracia thotë që ne edhe pse i kemi 10 milionë, i rrëzojmë këta që i kanë 1 miliard e gjysmë, se buxheti i Kuvendit të Republikës, kryetar i Kuvendit, ju e dini shumë mirë që është 10 milionë euro. Aty e kanë futur edhe 8 milionë RTK-në, në mënyrë që të dukemi që kemi më shumë buxhet se sa Zyra e Kryeministrit, që është 12 milionë, por e vërteta është që ky Kuvend ka më pak buxhet se sa Zyra e Kryeministrit.

Ne kemi zhvilluar takime me Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës. Kemi pasur takime me Lidhjen Demokratike të Kosovës, në vitin

e kaluar, më 22 shkurt, më 11 mars e më 25 mars. Kemi shkuar në zyrën e profesor Sabri Hamitit si nënkryetar i Kuvendit, ku unë bashkë me Visarin jemi takuar me profesorin dhe me kryetarin Isa Mustafa.

Gjithashtu edhe kryetari Isa Mustafa ka ardhur në zyrë të Visarit, ku kemi pasur një takim unë dhe ai. Kemi shkuar edhe në zyrën e Lidhjes Demokratike të Kosovës, në zyrën partiake dhe kemi zhvilluar takim, gjithnjë në funksion të krijimit të bllokut opozitar.

Me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës kemi shkuar po ashtu, në zyrën partiake e ka ardhur edhe zoti Haradinaj, por natyrisht që ne jemi subjekte të ndryshme, nuk i kemi qëndrimet e njëjta, nuk i kemi as vizionet e njëjta dhe nuk jemi i njëjti subjekt. Natyrisht, që jemi kritikuar edhe me njëri- tjetrin, mirëpo besoj që nëse me të vërtetë e duam rrëzimin e Qeverisë, atëherë ky është i mundshëm. Nevojitet një takim ndërmjet kryetarit të LDK-së, të AAK-së edhe meje, që të merremi vesh për tekstin e mocionit të mosbesimit ndaj kësaj qeverie dhe kësaj ta rrëzojmë Qeverinë.

Pra, kjo është e mundshme të bëhet, por nevojitet dëshira, përkatësisht vullneti. Unë e di që Lidhja Demokratike e Kosovës e ka ndërruar kryetarin e vet, në mënyrë që të jetë më larg prej Thaçit, pra e keni hequr Fatmir Sejdiun dhe e keni sjellë Isa Mustafën për t'u larguar prej Thaçit, jo për t'u afruar me Thaçin. Ndërkaq, kjo çka po ndodh sot është afërm.

Pra, më 2 nëntor 2010 Ibrahim Makolli, që s'qenka këtu për momentin, ai i pat ndihmuar Qeverisë që ta rrëzojë veten e ta rifreskojë veten. Nuk ka nevojë për Ibrahim Makolla më.

Dhe, Lëvizja "Vetëvendosje" është e gatshme që me LDK-në dhe me AAK-në ta nënshkruajë një dokument të përbashkët, që pavarësisht se kur mbahen zgjedhjet edhe cili është rezultati i zgjedhjeve, asnjëra s'do të bëjmë koalicion pas zgjedhjeve me PDK-në. Ne jemi të gatshëm ta nënshkruajmë këtë, sepse nuk mund të ketë ndryshim në qeverisje, nëse PDK-ja mbetet në qeverisje. Edhe, besoj që edhe për PDK-në është mirë të jetë në opozitë, po këta natyrisht, që nuk kanë mundësi ta kuptojnë këtë gjë.

Ama, mirë kishte qenë edhe për këta vetë të dalin në opozitë, se po se po për Republikën, shtetndërtimin e demokracinë e zhvillimin ekonomik. Pra, një takim i përbashkët i krerëve opozitarë LDK, AAK dhe "Vetëvendosje", mendoj që do të mund të na sillte te një tekst i cili do të ishte i pranueshëm për rrëzimin e kësaj qeverie.

I kemi pasur vërejtjet tona, i kemi thënë edhe publikisht. Pra, vërejtja jonë ka qenë pjesëmarrja e deputetit Shala në delegacionin në Bruksel dhe fakti që nuk po përmendet dialogu në tekstin e mosbesimit ndaj Qeverisë. Pra, kanë qenë parimore.

Nuk e kemi nënshkruar mocionin e mosbesimit të AAK-së, jo për inat, as për shkaqe personale, as kush e mori nismën, po për shkak të këtyre dy elementeve. Po, unë jam i bindur që përkundrazi, ne sot në një situatë emergjente, mund të merremi vesh. Pra, është e mundshme që AAK-ja, LDK-ja dhe "Vetëvendosja", të ulen dhe të merren vesh.

Mendoj që LDK-ja po ashtu, nuk ka arsye që të mos e nënshkruajë të AAK-së, se këto dy vërejtjet tona që i kemi, ata realisht nuk i kanë, për shkak se është ratifikuar edhe prej tyre Marrëveshja Thaçi-Daçi dhe amnistimi i kriminelëve serbë nga veriu që qe bërë atëherë.

Pra, mendoj që është e mundshme që të ulemi bashkë dhe të merremi vesh për këtë gjë. Prandaj, njëherë mund të fillohet me takimin ndërmjet shefave të grupeve parlamentare, por nëse ju ngutet, shkojmë edhe drejtpërsëdrejti tek udhëheqësit e subjekteve tona edhe kësisoj e parandalojmë këtë sabotim Republikës, që po ia bën kjo qeveri me tentimin për ta shpërndarë Kuvendin.

Më tutje, besoj që duhet ta kemi parasysh se kronologjia e zhvillimeve e shpjegon situatën aktuale sot. Nuk është se kryeministri i Kosovës premtoi ushtrinë dhe mandej doli problemi i ulëseve të rezervuara, është saktësisht e kundërta. Ky kryeministër e ka premtuar në Bruksel të Daçi vazhdimin e ulëseve të rezervuara dhe për dallim prej neve që nuk na i plotëson premtimet, atje te baronesha Eshton edhe te Daçi s'ka qare pa i plotësuar premtimet dhe thotë, që meqenëse do të bëhen ulëset e rezervuara edhe për një dy mandate, le të nxjerrim diçka edhe për Kosovën, le të jetë kjo ushtria.

Prandaj, kur ishte në seancën e fundit, ai tha: “nëse s’e bëjmë ushtrinë tash, duhen edhe s’e disa vjet për ta bërë”. Pse? Duhet pritur vitin 2018, kur duhet prapë duhet vazhduar ulëset e rezervuara e ndoshta atëherë për ta nxjerrë ushtrinë.

Kjo ideja e ushtrisë si aneks i një procesi qendror, që është dialogu me Serbinë dhe vazhdimi i ulëseve të rezervuara e bën tërësisht joserioze edhe nismën për ushtrinë e Kosovës, e cila duket që më parë përveç se s’do të quhet ushtri, do t’i ndërrohet emri dhe numri i pjesëtarëve, jo armatimi, përgatitja, gatishmëria, operacionet, e kështu me radhë.

UÇK-ja, ju e dini që ka lindur në konfrontim radikal me Serbinë. Tash, unë s’di qysh shfaqet kjo qeveri e befasuar, ku thotë që “vëlla, s’po mund ta bëjë ushtrinë, se Beogradi po thotë, jo” Nuk ka kuptim, Kosova për ushtrinë e saj për të pritur leje prej Beogradit 15 vjet pas çlirimit e 6 vjet pas shpalljes së pavarësisë.

Më tutje, ashtu qysh patën thënë në vitin 2007, po e shpërbëjmë TMK-në, a mbasandaj thanë “jo, po e shuajmë TMK-në”, edhe me Kuvendin po ia bëjnë njësoj, kinse po e shpërbëjnë Kuvendin, po ideja është për ta shuar këtë Kuvend. Qeverisë i ka penguar ky Kuvend tash e tre vjet, sidomos. Prandaj, të kurorëzohet me shpërndarje të Kuvendit entiteti më rezistues në institucionet e Republikës ndaj kësaj qeverie, është absurde.

Dhe besoni, nëse shkojmë në zgjedhje me shpërndarje të Kuvendit, ne e humbim ofensivën si opozitë. Nëse ne e rrëzojmë Qeverinë, ne hyjmë në zgjedhje si subjekte opozitare me ofensivë e ofensiva është çelësi i fitores. Prandaj, ne duhet ta rrëzojmë Qeverinë dhe me ofensivë të hyjmë në zgjedhjet e ardhshme në këtë vit.

Dhe, në fund krejt, desha të them që nisma për t’i vazhduar ulëset e rezervuara është prej Serbisë...

(Ndërprerje nga regjia.)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Edhe një minutë!

ALBIN KURTI: Unë e di që ka deputetë opozitarë, ka deputetë edhe të pakicave, të cilët nuk pajtohen me këtë qeveri, mirëpo nuk do të duhej që ky mospajtim i vazhdueshëm tash të kurorëzohet me shpërndarjen e Kuvendit. Dhe, deputetët e pakicave që duan t'u vazhdohen ulëset e rezervuara, jo domosdoshmërisht janë duke e dëgjuar Beogradin, kanë interes ata vetë.

Mirëpo, nisma, origjina është e Beogradit. Kur e ka parë Serbia që Kosova s'po bëhet me shumë zona, ku do ta kishte zonën e vetë virtuale, veriun me enklavat, përafërsisht territori i asociacionit të komunave me shumicë serbe, kur e ka parë që s'po mund të bëhet kjo, atëherë ka thënë "të vazhdohen ulëset e rezervuara" dhe kryeministri Thaçi i ka thënë "po" Daçiqit, atje.

Pra, ky i ka lënë pengë atje te Daçiqi dhe tash po dëshiron që ta marrë Kuvendin me vete. Mendoj, që është një shans i jashtëzakonshëm që të mos shpërndahet Kuvendi, po të detyrohet ky kryeministër të japë dorëheqje.

Paramendoni, e premtoi ushtrinë, nuk e bëri, e premtoi shpërndarjen, nuk e bën, ky s'ka ku shkon më.

A po e kuptoni, qysh e keni në dorë kryeministrin Thaçi sot? Në fakt...

(Ndërprerje nga regjia.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zoti zëvendëskryeministër, Hajredin Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Unë e kuptoj këtë logjikën që në votë opozitarizëm edhe sot e besoj që prej sot do të fillojë edhe fushata elektorale, ndërsa jo formalisht prej nesër, ndërsa formalisht pak më vonë.

Por, dy-tri gjëra duhet t'i themi, besoj, shumë hapur. Në demokraci fuqia politike matet me votë dhe nëse në një pushtet demokratik, në një vend demokratik, dy parti të mëdha kërkojnë zgjedhje, unë besoj që s'ka logjikë tjetër, që dikush tjetër ta pengojë një proces të tillë. Dhe, në këtë rast e kemi partinë më të madhe në vend, Partinë Demokratike dhe partinë e dytë Lidhjen Demokratike, që është në opozitë dhe kërkojmë zgjedhje.

Kur i marrim parasysh këto dhe kërkesën kushtetuese, që është vënë në rend të ditës, duhet të procedohet, nuk ka mocion tjetër sot, ose angazhim tjetër, sot është kjo në rend dite.

Çështja e dytë është që me disa liderë të partive politike, unë kisha dashur që në këtë vend t'i shohim liderët e partive politike, njerëz të cilët e masin kapacitetin e vet me fuqinë e votës që e kanë, jo me atë aurorën që ia bëjnë rrethi i tij, ose me atë background-in, që mund t'i thotë vetes politik, akademik, patriotik, apo tjetër. Dhe, kjo i bie që kur flet dikush, duhet të flasë vetëm për përqindjen që e ka në mbështetje të popullatës.

Dhe, krejt e fundit, mos të na e luajë rolin “e babës së kombit” askush, ne kemi parti të ndara politike, do të dalim të matemi prapë, do ta shohim veten. Unë po ju them, që ne do të jemi fer, në mënyrë demokratike do t'i respektojmë proceset. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ismet Beqiri ka kërkuar replikë.

ISMET BEQIRI: Zoti nënkryetar!

Ne jemi në një proces, në një seancë të përcaktuar më herët. E thashë dhe po e përsëris, për Lidhjen Demokratike të Kosovës është e rëndësishme të shpërndahet Parlamenti dhe kjo qeveri t' i humbë mandatet, gjegjësisht edhe postin e tyre të gjithë qeveritarët në zgjedhje.

Çdo gjë tjetër, që tash po tentohet, është për mendimin tim, tentim për t'u shtyrë zgjedhjet.

Ne jemi të interesuar që zgjedhjet të mbahen në qershor. Dhe, këto mund të mbahen, normalisht, nëse vendos Kuvendi të shpërbëhet, ne ua kemi thënë edhe partive tjera. Zoti Kurti po flet, por e di mirë, unë ka katër muaj kur ka fillua cikli i takimeve me partitë tjera, këta s'kanë pranuar.

Unë nëpërmjet Visar Ymerit kam kërkuar takime dhe sot po dëshirojnë takim. Unë po e them shumë qartë, kemi thënë... po mirë, është problem i juaji. Unë kam kërkuar takim ndërmjet zotit Mustafa, kryetarit tonë dhe Albin Kurtit. Kurrë s'e kemi ftuar, se s'e kemi mandatin ne të thërrasim në takime, kur është edhe zoti Thaçi.

Mos i ngatërroni sendet edhe mos thoni gjëra të pavërteta. Ndërkaq, e kemi thënë shumë qartë, nëse ky Kuvend nuk voton për shpërbërje, ne jemi të gatshëm të shkojmë në mocion dhe e dinë zoti Gjini, jemi pajtuar mocion të mosbesimit.

Por, unë po e them qëndrimin e LDK-së. Qëndrimi ynë është shumë i qartë. Ne jemi që të procedohet, të shpërbëhet Parlamenti dhe të shkojmë në zgjedhje. Çdo gjë tjetër unë mendoj që është tentim për t' i shtyrë zgjedhjet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Ramadani.

BURIM RAMADANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Pavarësisht faktit se zoti Kuçi realisht e sqarojë qartë dhe pa se kush është dhe e kujt është kjo ide që të shkohet nëpërmjet shpërndarjes së Kuvendit, unë mbi të gjitha vërtet po shpresoj se kjo është hera e fundit që ky Kuvend flet për Qeverinë Thaçi dhe se kjo do të jetë dita e fundit kur këta pushtetarë vijnë si zëvendëskryeminsitra e si ministra, të cilët realisht sikur që po shihet shumica e tyre nëse jo krejt janë kokulur dhe definitivisht të padenjë për ta vazhduar udhëheqjen e Kosovës.

Dhe, në fakt kjo udhëheqje nuk ka qenë kohë e shkurtër. Mos harroni se bëhet fjalë për gati 7 vjet në daç në Qeverinë e parë dhe në daç në Qeverinë e dytë, të cilët këta qeveritarë ose pushtetarë definitivisht kanë shkuar prej qoshes në qoshe duke këqyrë mundësitë vetëm për pasqyrim dhe për manipulim.

Kjo definitivisht është e qartë se asnjëherë nuk kanë bërë ndonjë punë të mençur për Kosovën dhe asnjëherë nuk kanë bërë ndonjë punë të mençur për popullin e Kosovës.

Gati 7 vjet ka zgjatur kjo periudhë dhe vërtet po shpresoj dhe jam i bindur se pas kësaj dite do të shkojnë atje ku e kanë vendin dhe kjo është në opozitë.

Në fakt gjatë kësaj periudhe për gati 7 vjet, qytetarët e Kosovës definitivisht janë bombarduar me skandale, afere të ndryshme, të përditshme, të llojllojshme, të pandalshme dhe në të njëjtën kohë nuk kanë parë asnjë veprim ligjor ndaj kësaj garniture të pushtetarëve.

Vendi ynë definitivisht vuan keq prej mungesës të rendit dhe të ligjit dhe për këtë jemi dëshmitarë të gjithë. Qytetari nuk është i barabartë dhe pushtetarët janë sjell definitivisht në formën sikur se janë pronarë të shtetit dhe të popullit.

Nuk mund të harrohen skandalet e kësaj Qeverie në në daç po e them edhe një herë në Qeverinë e parë në daç në Qeverinë e dytë. Nuk mund të harrohet kurrë në Kosovë asnjëherë vjedhja e Dhomës së Dëshmimeve në qendër të Prishtinës, në Policinë e Kosovës. Askush nuk është dënuar, asnjë njeri.

Nuk mund të harrohet asnjëherë tenderi i Pallatit të Medieve ndërmjet Thaçit dhe Pacollit përkundër që Kuvendi ka marrë vendim tjetër. Askush nuk u dënua.

Nuk mund të harrohet vjedhja në tenderin e pasaportave. Askush nuk u dënua.

Nuk mund të harrohet keqpërdorimi, qoftë në ndërtim të shkollave, qoftë në ndërtim të rrugëve dhe askush nuk është dënuar.

Nuk mund të harrohet rrahja e policit prej djemve të pushtetarit. Askush nuk u dënua. Dhe kjo nuk do të harrohet asnjëherë.

Nuk harrohet një qeverisje e keqe e cila është përcjell gjatë tërë kohës me tenderomani, me klientelizëm dhe me nepotizëm.

Është tepër e qartë se shpërndarja e Kuvendit nuk është fundi që është dashur t'i jepet kësaj qeverisje të keqe. Ky nuk është përfundimi që vërtet e ka merituar kjo Qeveri. Kjo nuk është përgjigja e vërtet dhe e saktë që partitë opozitare do të duhej t'i jepnin kryeministrit Thaçi dhe kësaj logjike të qeverisjes.

Përgjigja e vetme e duhur do të ishte shkarkimi dhe ky do të ishte shkarkimi i dytë dhe definitivisht shkarkimi i fundit i kryeministrit Thaçi nga pozita e kryeministrit.

Sidoqoftë pse e fundit, sepse jam i bindur se Kosova më nuk do të dështojë. Ka dështuar dy herë në zgjedhje të zotit Thaçi për kryeministër dhe dështimi i tretë është dështim fatal për Kosovën. Dhe, ky dështim nuk do të ndodhë dhe jam i bindur se kështu do të shihet prej vullnetit të qytetarëve i cili nëse e vazhdon mundësia për shpërndarjen e Parlamentit, zgjedhjet do të mbahen jo më larg se një muaj, gati një muaj prej tash.

Në fakt kjo mundësi që iu ka hequr prej dore opozitës, partive opozitare për ta shkarkuar Qeverinë, do t'u kthehet qytetarëve, do t'i kthehet votës së vullnetit të qytetarëve për ta ndëshkuar logjikën e keqe të shkatërrimit të Kosovës që ka ndodhur gjatë këtyre viteve.

Prandaj, jam i bindur se Kosova nuk e ka luksin që madje asnjë sekondë më tutje të qeveriset prej një politike të tillë nga një grup njerëzish të korruptuar e të shantazhuar të cilët nuk kanë asnjë qëllim tjetër përpos qëllimeve personale ose keqpërdorimeve të caktuara të buxhetit të popullit të Kosovës.

Në fakt janë dëshmuar për gati shtatë vjet se nuk janë njerëz që mund të ndërtojnë të ardhmen e fëmijëve tanë, fëmijëve të Kosovës, nuk kanë as dije dhe as vullnet për të bërë këtë. I kemi parë dhe i kemi provuar për gati shtatë vjet, i kemi parë dhe i kemi provuar në xhepat tonë, në xhepat e qytetarëve të Kosovës.

Ky duhet të jetë fundi, fundi i një logjike të keqe të qeverisjes, fundi i kësaj logjike të manipuluesve.

Në fakt, përpos fundit të mos harrojmë se një ditë drejtësia do të funksionojë në Kosovë. Të gjithë ata që janë marrë me keqpërdorim do të vijë një moment kur do të përballen me drejtësinë. Dhe, kjo vlen për të gjithë, pavarësisht pozicioneve ose pavarësisht partive politike.

Ky duhet të jetë fundi dhe fjala e fundit është: Mos u kthefshi më! Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Për debat janë lajmëruar edhe 12 deputetë. Unë mendoj që është mirë të tërhiqeni, pra ta marrin fjalën edhe nga një deputet për grup. Bëjeni ju fushatën pas kësaj seance, mos i harxhoni krejt fishekët në këtë seancë!

Fjalën e ka deputetja Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Fillimisht dëshiroj t'ju njoftoj se vota ime është kundër kësaj kërkesë dhe dëshiroj t' ju njoftoj me arsyet se pse jam kundër kësaj kërkesë.

Në kërkesën të cilën e kemi të gjithë do të thotë siç u përmend edhe më herët, e kemi një arsyetim që është arritur një marrëveshje ndërmjet liderëve politikë. E vërteta është se kjo marrëveshje është arritur ndërmjet dy liderëve të dy partive më të mëdha, të LDK-së dhe PDK-së, sepse 28 nënshkrime i ka Lidhja Demokratike e Kosovës, 27 nënshkrime i ka Partia Demokratike, 2 janë të Lëvizjes për Bashkim dhe 1 është i përfaqësuesit të komunitetit ashkali.

Do të thotë, mungojnë nënshkrimet e partive tjera opozitare, apo edhe partive tjera që janë në pozitë.

Kisha për ta arsyetuar një kërkesë të Lidhjes Demokratike të Kosovës që thotë: Qeveria duhet sa më shpejt të shkojë në shtëpi, sikur një kërkesë e tillë dhe një vendosmëri e Lidhjes Demokratike të ishte para një viti, apo edhe para dy vjetëve.

Pastaj thuhet të ruhet funksionalizimi i institucioneve. Në këtë rast shpërbëhet Kuvendi që nuk ndodh në asnjë vend, kurrë s'kam dëgjuar Kuvendi ta shpërbërë vetveten. Hera e parë në Kosovë. Këta po e shpërbëjnë vetveten. Pse ka qenë Kuvendi jofunksional, për shembull? Ka qenë sepse ka pasur bojkotime të partive më të mëdha të pozitës dhe të opozitës.

Ju kujtohet shumë mirë lëshimi i kësaj salle në mungesë të Partisë Demokratike me rastin e privatizimit të Postës, kur Lëvizja "Vetëvendosje" ka bërë kërkesë për hetim parlamentar, për formimin e Komisionit Parlamentar për hetim se si është privatizuar Posta, Partia Demokratike ka dalë. A thua pse? Pse keni qenë kundër?

Thuhet, thashë edhe më herët, të shpërbëhet Kuvendi. Ku është faji i Kuvendit këtu? Të mbahen zgjedhjet e lira dhe demokratike. Të kthehemi në 2010, a kanë qenë zgjedhjet e lira dhe demokratike. A ka pasur hajni? Krejt kemi pasur vërejtje këtu që kanë qenë shumë deputetë dhe shumë njerëz këtu që kanë ardhur me vota të vjedhura.

A do të kemi tash zgjedhje të lira dhe demokratike, menjëherë ju them se jo. Fillimisht përgatitjet nuk janë, e dyta nuk e kemi pastrimin e listave që e dimë se shumë veta figurojnë dhe të njëjtën e ka pranuar edhe ministri i Punëve të Brendshme dhe kemi gjithashtu pengesë të Diasporës se si do të votojë.

Një arsyetim i cili ishte nga kryeministri, ishte pikërisht ky rreth nënshkrimeve, ishte se do të kemi zgjedhje të lira demokratike që nuk qëndrojnë. Një ndër arsytet ishte mos formimi i forcave të armatosura të Kosovës, respektivisht ndryshimi i emrit i cili pikërisht nga ju edhe u shty në seancën e kaluar për të votuar të nesërmen dhe tani merret si arsyetim sepse po shpërbëhet Kuvendi.

Këto janë arsytet e mia që do të votoj kundër dhe shpresoj se nëse kalon kjo kërkesë nuk do të vjen puna të themi se e kemi pasur me të drejtë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputete, Kuvendi po shpërbëhet pse pozita nuk i ka numrat të marrë vendime në Kuvend dhe pse opozita nuk i ka numrat ta rrëzojë Qeverinë.

Vazhdojmë. Fjalën e ka deputeti Fatmir Limaj.

FATMIR LIMAJ: I nderuar kryetar i Parlamentit!

Të nderuar miq,

Sot në Parlament ka shumë mbështetës të Nismës, po më vjen mirë, sa herë që fillojmë me nismë s'ka qare pa pasur ndryshime.

Unë mendoj që kemi pritur që nuk ka nevojë të zhvillohet debat, është një kërkesë krejt konkrete dhe po ma merr mendja se është krejt e pa vend të zhvillohet debat rreth kësaj kërkesë, mirë është të shkohet drejt votimit dhe të vendoset me votë si do të vendosim më tutje.

Por natyrisht pasi që është ndoshta seanca edhe e fundit e Parlamentit të Kosovës dhe jemi gati në frymën e fushatës besoj që edhe ata që po na përcjellin do ta kuptojnë se një pjesë e madhe e fjalëve tona këtu është në frymën e asaj që po vjen.

Mua ma merr mendja që kur diçka fillon jo mirë, kur diçka fillon jo në rregull, kur diçka fillon ashtu siç ka filluar ky Parlament, nuk ka fund tjetër përveç ky fund që po i vjen kështu.

Tash, shkarkim, shpërbërje është krejt formale. Është formale më tepër, por në fakt edhe vetë ardhja e shpërbërjes së Parlamentit e ka kuptimin e vet, pse po vjen deri te shpërbërja. Sigurisht se po të ishte puna mirë, po të ishim të organizuar mirë, po të ishte krejt rezultati si duhet, nuk do të vinte deri te shpërbërja e Parlamentit.

Natyrisht se në suaza tjera opozita do të donte të kishte një kartë edhe më të fuqishme dhe kjo është krejt legjitime, por si do që të jetë esencën kjo nuk e humb.

E mbi të gjitha, kjo gjendje që është krijuar në këto vite në Parlamentin e Kosovës dhe ky përfundim i Parlamentit të Kosovës, duhet të përcillet, të shihet si mesazh për ata qindra mijëra qytetarë të Republikës së Kosovës që të jenë të kujdesshëm nesër kë po votojnë dhe çfarë përbërje të Parlamentit po na sjellin në Parlamentin e ardhshëm.

Ky Parlament dhe kjo përbërje nuk ka mund të përfundojë ndryshe. Ka filluar mbrapsht dhe duhet të përfundojë kështu siç është sot, qoftë me shpërbërje, qoftë me shkarkim këto më tepër është për mendimin tim tash janë finesa e nuanca, por në fund objektivi arrihet të shkohet drejt zgjedhjeve dhe t'u mundësohet njerëzve dhe qytetarëve të Republikës që të vendosin me votën e tyre për një përbërje dhe unë shpresoj që Parlamenti i Kosovës do ta ketë një përbërje serioze dinjitoze.

Pres që nesër në Parlamentin e Kosovës të mos kemi deputetë të cilët flasin ndryshe e votojnë ndryshe, pres që të mos kemi nesër deputetë në Parlamentin e Kosovës që s'kanë as mendim e as qëndrim, pres që nesër të mos ketë deputetë të Parlamentit të Kosovës që me sms e ndërron mendimin duke shkuar në foltore, pres që Parlamenti i ardhshëm i Kosovës të ketë profesionistë, deputetë të cilët me dinjitet do të dinë të mbrojnë , të përfaqësojnë interesat e vendit të tyre për çka zgjidhen.

Në fund, të nderuar miq, e deputetë, ne mund të bëjmë gara fjalësh këtu sa të doni, por thjesht të gjithë kur të dalim nga ky Parlament duhet ta kemi një parasysh, asnjëri nga ky Parlament, kush më shumë e kush më pak nga kjo përbërje e cila do të shënohet në arkivin e Parlamentit të Kosovës, një gjë jam i sigurt, asnjëri me kokën lart nuk ka për të dalë nga ky Parlament.

Kush më shumë e kush më pak, asnjëri nga deputetët e këtij Parlamenti nuk ka pse të krenohet për këto katër vjet ose tri vjet të punës së këtij Parlamenti.

Dhe në fund, kush më shumë e kush më pak, secili nga pak dinjitet të vet ka humbur në këtë Parlament të Kosovës.

Shpresoj që parlamentet e ardhshme ose përbërjet e ardhshme nuk do t'u nënshtrohen me vetëdije shkeljeve të ligjeve, shkeljes së Kushtetutës dhe mos mbrojtjes së interesit të vendit.

Po në fundit të fundit këtu janë qytetarët e Republikës së Kosovës që do të vendosin e ata besoj që kanë shumë më shumë se ne kanë parë, shumë më shumë se ne e dinë kush çka ka bërë, shumë më shumë se ne kanë përcjell angazhimet e secilit veç e veç dhe ata në fund do të gjykojnë dhe do të vendosin, e ne shpresojmë që do t'u krijojmë hapësirën e mjaftueshme që në mënyrë demokratike, të lirë njerëzit të vendosin dhe gjykojnë, qoftë për punën e deritanishme, qoftë për ata që do të vijnë në të ardhmen.

Parlamenti jonë po shkon edhe mirë po bën ky Parlament që po shpërndahe duke shpresuar që përsëri po e them duke shpresuar se do të na vijë një përbërje shumë më e dinjitetshme, shumë më e fuqishme, shumë më profesionale, shumë më e gatshme për t'u ballafaquar me sfidat dhe problemet të cilat e presin këtë vend. Faleminderit!

KRYETARI: A po i shkurtoni llafet, a jo? Deputeti Xhafer Tahiri e ka fjalën.

XHAFER TAHIRI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë dhe deputete,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Në këtë kohë të ekzistimit të këtij Parlamenti, një prej vendimeve më të rëndësishme, ndoshta edhe më i rëndësishmi pa diskutim është ky vendim i sotëm për shpërbërjen e tij për faktin thjesht, sepse që në themelim të këtij Parlamenti ka pasur akuza për vjedhje industriale të votave dhe asnjëherë kjo mazhorancë në këto tre vjet të punës së vet nuk ka arritur të dëshmojë se qoftë edhe për një moment të vetëm ka pasur interesin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, para interesave të ngushta klanore e partiake.

Në fund të këtij mandati qeverisës të kësaj Qeverie në ikje, unë nuk kam pyetje për këtë Qeveri, por unë kam pyetje për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Pyeteni veten në këto tri vjet të kësaj qeverisjeje: a keni arritur të merrni qoftë edhe një shërbim të vetëm nga shteti pa pasur intervenime tek njerëzit e këtij pushteti? Përgjigjja është shumë e thjeshtë: jo.

Mendoj se retorikat...

... për atë se eja tash të bëjmë mocion mosbesimi, apo retorika e zotit Kurti se ai që i ka paratë më shumë e sundon atë që ka para më pak, është teori thjesht e Marksit dhe Engelsit dhe ata që i kanë lexuar librat e tyre e dinë këtë shumë qartë. Ndoshta ai do të donte që të ishte një Marks ose Engels i vogël këtu në Parlamentin e Kosovës, por koha e tyre ka përfunduar, vendi i tyre është në histori dhe Kosova nuk ka nevojë për teori të tilla.

Në këtë kohë, krejt këto diskutime edhe propozime - unë e kam vetëm një kërkesë dhe një pyetje: A jeni të gatshëm që nëse nuk ka sukses mocioni i mosbesimit ndaj Qeverisë ta merrni përgjegjësinë morale para qytetarëve të Kosovës për vazhdimin e mandatit të kësaj qeverisjeje dhe...

(Reagime nga salla)

...deri në shtator, apo deri në vjeshtë. Ju duhet të merrni, meqenëse keni dalë sot këtu dhe po propozoni mocione, thjesht sepse jeni të gatshëm për t'ia vazhduar mandatin kësaj Qeverie, ju duhet të jeni të gatshëm ta merrni përgjegjësinë politike dhe morale para qytetarëve të Kosovës për vazhdimin e mandatit të kësaj qeverisjeje deri në shtator, nëse mocioni është jo i suksesshëm. Është shumë e qartë dhe kryetari i Kuvendit e tha shumë qartë, opozita për fat të keq nuk i ka numrat për ta rrëzuar Qeverinë nëpërmjet mocionit, ashtu siç është paraparë me Kushtetutë dhe me ligj. Ata numra thjesht nuk ekzistojnë. Dhe, ju duhet të jeni të gatshëm ta merrni përgjegjësinë morale, politike, prapë po e them, për vazhdimin e mandatit të kësaj qeverisjeje në rast se dështon mocioni.

Sot është shumë qartë, shumë thjesht. Është sukses i kësaj opozite që ka arritur që sot Kuvendi i Kosovës në seancë të jashtëzakonshme ta fusë në mocion shpërbërjen e Parlamentit dhe me këtë shpërbërjen e Qeverisë dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme, zgjedhjet e parakohshme, në të cilat qytetarët e Republikës së Kosovës me votën e tyre do ta kenë rastin ta legjitimojnë udhëheqjen e ardhshme të Kosovës.

Çështja më e rëndësishme sot këtu është që zgjedhjet duhet në mbahen në qershor, kur qytetarët do të kenë mundësi me votën e tyre ta ndëshkojnë këtë mazhorancë në ikje.

Prandaj, unë ju ftoj sot, të nderuar kolegë të opozitës, të bashkohemi në këtë, të bashkohemi të gjithë së bashku që ta rrëzojmë këtë Qeveri, këtë mazhorancë, që vendi të shkojë në zgjedhje dhe me anë të votës në zgjedhje ta ndryshojmë këtë mazhorancë, këtë qeverisje. Kjo është më e rëndësishmja. Ky është hapi më i rëndësishëm për demokracinë në vend, për institucionet e këtij vendi.

Prandaj, ejani të bashkohemi në këtë, të mos merremi sot me akuza ndaj njëri-tjetrit. Të gjithë e dimë se çka është bërë në këtë Parlament për këto katër vjet, të mos të flasim për institucione, zoti Kurti. LDK-ja është institucion, kur mos flitni për LDK-në, sepse ajo është institucion i këtij populli, i këtij vendi. Nuk keni të drejtë kurrë të flitni, e lëre më t'i gjykoni veprimet e LDK-së, sepse LDK-ja është institucion i këtij populli. Me 24 vjet traditë dhe histori është institucion në këtë vend. Faleminderit!

KRYETARI: Bëhuni të durueshëm! Ju e dini që në demokraci, dihet cila moshë ka prioritet dhe përparësi. Fjalën e ka deputeti Florin Krasniqi.

FLORIN KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Pasi u hap debati politik, unë mendova se sot jemi këtu për të votuar për Kuvendin, a po e shpërndajmë, apo jo. Por, pasi po bëjmë debat politik - një sqarim shumë të thjeshtë.

Lëvizja “Vetëvendosje” është parti e qendrës së majtë, vetëm e qendrës së majtë.

Programi ynë social përkon me atë çfarë ne besojnë. Programi social përkon me kanunin tonë, me Kuranin dhe me Biblën.

Programet e juaja nuk e di ku bazohen. Por, një gjë dua ta bëj shumë të qartë, edhe për ata që janë shumë më të rinj. E kam fjalën për disa këtu që janë shumë të rinj, e nuk e mbajnë në mend shkollën e Kumrovcit. Mbajeni në mend, kush e ka kryer shkollën e Kumrovcit e ka dhënë betimin për të qenë komunist. Do të vdesë komunist. Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo kërkesë e deputetëve nënshkrues është fyese për Parlamentin e Republikës së Kosovës, sepse në vend se ta marrë dënimin e merituar ai që e ka sjellë këtë gjendje, këtu po kërkohet të sakrifkohet dikush tjetër, që në fakt është Kuvendi si institucion.

Ju lutem, në vetë letrën thuhet shumë mirë: ‘Duke u bazuar në marrëveshje të liderëve’, e ju e dini që liderë ka shumë në Kosovë, por vetëm dy liderë janë pajtuar për këtë marrëveshje dhe jo të tjerët, dhe nuk kanë bërë marrëveshje as për datën, as për asgjë tjetër, por janë marrë vesh dy liderë, të cilët në fakt ditën e Shën Valentinit e kanë mbërri, sepse edhe ditën e kanë zgjedhur, normalisht jo rastësisht.

Për Parlamentin e Republikës së Kosovës, një gjë duhet të jetë e qartë. Kjo Qeveri që e ka sjellë këtë gjendje, kjo duhet të dënohet, kjo duhet të shkarkohet. Kryeministri duhet të japë dorëheqje. Në çdo vend demokratik kjo ndodh, sepse edhe këtu kishte tendenca që edhe deputetëve t'u ndalet fjala dhe nuk është e mirë se për ata është Parlamenti, për të folur njerëzit e zgjedhur nga populli, në mënyrë që ta shprehin vullnetin e këtij populli.

Edhe po ju them shumë sinjerisht: Deputeti duhet ta mbrojë dinjitetin e vet, të mos lejojë që dikush i emëruar t'ia përcaktojë rrugën e vet se kur duhet të shkojë, ose kur duhet të vijë, por qytetarët janë ata që e bëjnë atë. Ndërsa këta të emëruarit duhet përcjellë sa më shpejt me shkarkim, sepse kështu kryeministri Thaçi e ka merituar për shkak se plot dy mandate nuk e përfundon mandatin normalisht, në bazë të Kushtetutës, në bazë të ligjeve në fuqi.

Edhe po ashtu një e pavërtetë e madhe, që i lihet si faj Parlamentit të Republikës së Kosovës, për themelimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës. Ne e dimë shumë mirë se nuk ka pasur koordinim në Qeveri, koalicioni ndërmjet veti, se Parlamenti i ka kryer obligimet e veta edhe nëpërmjet amendamentimit në komision, Gjykata Kushtetuese e ka dhënë mendimin e vet, por faji i kësaj Qeverie është pse sot Kosova është pa ushtri dhe për atë duhet dënuar, dhe ju kisha ftua që t'i bashkoheni nënshkrimit për shkarkimin e kësaj Qeverie, e vetmja mënyrë që drejtësia të vihet në vend, që vërtet kjo Qeveri të shkojë ashtu siç e meriton.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi. Sa më shkurt, do të ishte më mirë.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedniče!

Poštovani predstavnici Vlade,

Kolege poslanici,

Poštovani građani,

Obrazloženje koje smo dobili danas u vezi raspuštanja Skupštine Republike Kosova, 'na osnovu sporazuma postignuto između lidera političkih partija, u cilju očuvanja i funkcionisanje institucija Republike Kosova, mi potpisani poslanici Skupštine Republike Kosova, zahtevamo raspuštanje Skupštine Kosova, kako bi se otvorio put za održavanje slobodnih i demokratskih izbora'.

Gospodo, ko nam garantuje da će izbori biti demokratski, da neće biti kupovina i krađa glasova? Imamo jako loše iskustvo na poslednjim lokalnim izborima.

Bošnjačka zajednica u prizrenskom regionu je nailazila na veliki broj prepreka na samom danu izbornog procesa, za koji nismo znali da će se desiti. Promenjena su biračka mesta i birački centri, meštani su morali putovati nekoliko kilometara da bi obavili svoju građansku dužnost, odnosno glasali.

Veliki broj uslovnih glasova ne znamo kojoj političkoj partiji, ili zajednici otišao, što je za nas zabrinjavajući problem.

Svim političkim sredstvima i snagama borili smo za dobijanje opštine Rečane. Zahvaljujem se ministru za Lokalnu samoupravu, posebno premijeru, na odluci da napokon dobijemo i mi svoju opštinu, ali se plašim da taj proces ne traje večno, zato što je sem odluke Vlade, potrebno da se u Parlamentu, odnosno 81 glas, a kako imamo negativne diskusije od strane određenih albanskih političkih lidera po pitanju rezervisanih mesta kao poslanik u parlamentu Kosova javno iznosim zabrinutost da će to pozitivno da se reši u interesu Bošnjačke zajednice ukoliko ne postoji volja i politička podrška, svih političkih stranaka i zajednica unutar parlamenta Republike Kosovo.

Naravno, da podržavam slobodno i demokratske izbore za koje se nadam da će iz strane centralne izborne komisije biti održani fer, korektni i transparentniji ukoliko se danas raspusti parlament i idemo na vanredne izbore. Zahvaljujem se predsedniče!

KRYETARI: Deputeti Rasim Demiri e ka fjalën, le të përgatitet Berat Buzhala.

RASIM DEMIRI: Zahvaljujem se predsedniče!
Poštovani kolege poslanici.

Ja bih se nadovezao na riječi gospodina Premijera koji je u svom dosada najboljem govoru pomenuo opštinu Rečane, tako da na početku koristim priliku da čestitam Bošnjačkoj zajednici odluku premijera Hashima Thaçi o formiranju opštine Rečane. Ispred bošnjačke zajednice, ispred demokratske stranke bošnjaka Koalicija Vakati zahvaljujem se premijeru Vlade Republike Kosova, gospodinu Hashim Thaçi na ovu historijski i krupnu odluku za bošnjačku zajednicu.

Međutim mi u današnjem razgovoru sa premijerom obećano da nam je da pitanje decentralizaciju bošnjačku zajednici neće se zaustaviti samo sa opštinom Rečane već očekujemo da će ista odluka biti doneta i za buduću opštinu Dragaš odnosno Gora i buduću opštinu Vitimirica. Ujedno zahvaljujem se rukovodstvu koalicija Vakati kao i radnoj grupi koja je radila za ostvarivanje ovog velikog historijskog događaja za bošnjačku zajednicu i nadam se da će ovaj isti parlament izglasati kao što će biti u paketu za opštine kao što je premijer dakle naveo opština Has, Žegra, Rugova nadam se da će i opština Rečane biti isto izglasana u ovom parlamentu. Zahvaljujem!

KRYETARI: Berat Buzhala e ka fjalën. Shkurt bjeri, Berat!

BERAT BUZHALA: I nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sigurisht, kjo do të jetë edhe hera e fundit, e përshëndes deputetin Afrim Kasolli, i cili s'qenka këtu. Te "Udhëtimet e Guliverit", Jonathan Smith e përshkruan gjyshin e perandorit i cili kur ka qenë fëmijë e ka marrë dhe e ka thyer vezën kah ana e prapme këndeje, edhe stërgjyshi i perandorit aktual e sheh që e ka thyer ashtu edhe thotë: "këqyre, prej tash e tutje vezët duhet thyer kah ana e mbarë se nuk thyhet veza mbrapsht", dhe prej aty fillon një konflikt i rëndë i liliputëve me njëri-tjetrin.

Edhe komplet skena e liliputëve ndahet a me thye vezën nga mbrapa, a me thye vezën përpara. Edhe ky konflikt i përgjakur ka zgjatur me dekada e me dekada, e me dekada. Kështu që unë mendoj që këtij Parlamenti nuk i kish pasur hije kurrëgjë tjetër por veç kësaj përmbyllje që si liliputët të shtyhem i kah duam ta thyejmë vezën a para a mbrapa, kështu që për mua kjo është totalisht periferike, për mua është totalisht një përpjekje e mundimshme për ta zgjatur këtë farë gjakderdhje institucionale e cila po zgjat tash e katër vjet.

Prandaj, qysh doni nëse doni e thyejmë kah barku, nëse doni kah mbrapa, nëse doni përpara, qysh doni e thyejmë vezën. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Alma Lama e ka fjalën.

ALMA LAMA: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabineti më i madh qeveritar në botë që sot jeni të gjithë të pranishëm si asnjëherë tjetër.

Nuk do të ishte shumë normale të mos e merrja fjalën sot duke qenë që e kam marrë fjalën në çdo seancë të Kuvendit të Kosovës, për të bërë atë që duhet të bëjë një deputet opozitar për të kontribuar për vendin duke mbikëqyrur Qeverinë.

Unë sot do të numëroj disa nga dështimet e kësaj Qeverie, e cila prej sot mbaron afatin, skadon, i mbaron afati.

Një, Qeveria ka dështuar në procesin e liberalizimit të vizave. Ka dështuar për krijimin e Ushtrisë së Kosovës, ka dështuar për hapjen e vendeve të reja të punës, ka dështuar për të luftuar korrupsionin, por përkundrazi e ka rritur atë. Ka dështuar për të reformuar administratën publike, ka dështuar për të vënë kontroll në të gjithë hapësirën territoriale të Kosovës, ka dështuar për ta bashkuar Mitrovicën, ka dështuar për ta avancuar pozicionin juridik të Kosovës në arenën ndërkombëtare, ka dështuar për të rritur bashkëpunimin me Shqipërinë përveç shout mediatik.

Me pak fjalë, kanë dështuar për të konsoliduar shtetin demokratik. Prandaj, unë mendoj që është e domosdoshme të shkohet në zgjedhje të jashtëzakonshme. Në fakt, ka qenë e domosdoshme të shkohej më përpara. Nga kjo foltore e Kuvendit u bëj thirrje qytetarëve të Kosovës që në zgjedhjet e ardhshme të mbrojnë votën e lirë dhe demokratike, në mënyrë që të mos përsëritet vjedhja industriale e votave që ndodhën në vitin 2010.

Unë shpresoj dhe besoj shumë që qytetarët e Kosovës do të zgjedhin një Parlament dhe një Qeveri më cilësore dhe më të përgjegjshme e cila do të punojë tërësisht në interes të Kosovës e jo vetëm për interesa personale. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Politika madhore është shumë më pragmatike se kjo çfarë po ndodh në këtë vend, i cili shpeshherë për shkak të një qeverisje si qeverisja Thaçi bëhet vendi i çudirave. Prandaj, edhe sot kur ne diskutojmë këtu për të shpërbërë një Kuvend, në fakt kemi një shtet i cili ka 754 mijë njerëz të papunë. 754 mijë qytetarë, të cilët nuk kanë një vend pune si pasojë e një qeverisje e cila prej vitit 2007 s'ka ditur tjetër veçse ta vjedhë buxhetin i cili edhe kështu ka qenë i varfër dhe i pamjaftueshëm dhe çka na ka ndodhur? Hajnia e kësaj qeverie për çdo vit e ka ngushtuar Kosovën. Hajnia e kësaj qeverie për çdo vit e ka përkulur Kosovën dhe sot po bëhemi dhe po fyemi nga e njëjta qeveri e cila thotë : “ shpërbëhuni, sepse ju nuk e votuat ushtrinë” siç tha dje kryeministri në ikje.

Po, i nderuar kryeministër, mbrëmë gjatë gjithë natës ke bërë presion te deputetët, te koalicioni tuaj nëpërmjet formave edhe demokratike edhe jo demokratike, po flas për një numër të deputetëve të pakicave dhe ke mbërri që sot t'i sigurosh votat për shpërbërje, po konsiderohet ashtu.

Pse nuk llove që partnerët tuaj të koalicionit të votojnë ushtrinë? Ne gjithë ishim të gatshëm, jemi të gatshëm edhe sot dhe ky Kuvend është i gatshëm, në përjashtim të koalicionit qeverisës për të votuar për ushtrinë. Këtë po dua ta qartësoj.

Ndërkohë, nga premtimet megalomane të dy mandateve çka keni mbërri dhe çka kemi sot dhe cila është gjendja sot në Kosovë. Tisës dhe tragjedisë së Tisës i është shtuar edhe Hungaria dhe burgjet. Vizat jo që janë liberalizuar po Kosovës iu ka shtuar fusnota edhe së fundi iu ka shtua edhe Gjykata Speciale, edhe barrikadat në veri vazhdojnë të qëndrojnë edhe kjo na kujton se ku gjendemi sa i përket shtetësisë, sovranitetit dhe integritetit të vendit tonë.

Prandaj, është mirë për t' i lënë fjalët dhe është mirë për t'u bërë bashkë të gjithë ata të cilët bëjnë hipokrizi e në këtë rast po më kujtohet Gazmend Muhaxheri në Pejë, para nja 2-3 jave derisa flinte në një shtrat me PDK-në duke bashkë qeverisur me ta, deklaronte që asnjëherë PDK-ja nuk bëhet bashkë me LDK-në dhe fillimi i këtij bashkimit po shihet sot.

Prandaj, nëse keni vendosur të mos e amnistoni një qeverisje të keqe prej vitit 2007, ju ftoj sot që të bëhemi bashkë dhe përkraheni mocionin e Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës dhe ta rrëzojmë këtë qeveri të hajnave. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, zëvendëskryeministri Kuçi.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HAJREDIN KUÇI: Shikoni, të nderuar deputetë!

I kuptoj disa kandidatë që po flasin, kandidatë, nuk iu them deputetë më dhe besoj nëpërmjet këtij fjalori do ta fitoni një pozitë në listat tuaja, por është e mjerë një parti politike, nëse avancon dikë duke sharë të tjerët dhe jo duke ofruar vlera.

Po ashtu, do të propozoj që në Ligjin për zhurmën, decibelët e zërit të deputetëve të kufizohen jo vetëm për xhami dhe për kisha.

Dhe, krejt në fund po them kështu, nuk jemi të marrim para juve, as para qytetarëve të vendit. Nëse jemi tolerantë këtu, këtu nuk do të thotë që nuk kemi fytyrë t'ua kthejmë.

KRYETARI: Kundër-replikë një minutë, Donika!

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Nuk është hera e parë, që jeni munduar t'ia ndalni fjalën medieeve, deputetëve, është pjesë e mënyrës se si keni qeverisur prej vitit 2007 dhe nuk është asnjë problem. Por, nuk besoj që qeveria e ardhshme do ta përkrahë këtë propozim tuajin, sepse ju nuk do të jeni këtu që të propozoni.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Hamza Balje.

HAMZA BALJE: Zahvaljujem predsedniče!

Poštovani Vladin kabinet,

Poštovani zastupnici,

Poštovani građani,

Najpre bih hteo da poručim gospodi iz Koalicije 'Vakat' da su prerano počeli sa izbornom kampanjom i marketingom, jer svi znamo da su njihovi predstavnici od ranije izgubili te opštine, a sada kao ih i dobijaju, jer su ti zahtevi bili još 2009-te predati a za opštinu Goru i 2004-te godine.

Neminovnost jeste da se danas po svemu sudeći raspušta Parlament. Bez ikakve krivice, po mom mišljenju, znači za njegovo raspuštanje. Ostala su mnoga pitanja nerečena za koje neko mora da snosi posledice. I postavlja se vrlo bitno pitanje, da li je bitnije dobijanje opštine ili nedobijanje "dobijanje rezrevisanih mesta" o kome nije bilo ni rasprave.

Vrijeme će pokazati. Utrka je, kao što vidite, već počela i ja se nadam da će ovaj izborni proces biti korektan i da će naši građani napokon dobiti parlament kako zaslužuje, sa ljudima koji će stvarno zastupati njihove prave interese, a ne interese samo pojedinačnih partija, nekakvih samo prekovanih ili ideja.

Ako se daju opštine, onda opštine to zaslužuje i Gora i Rečane i Vitimirica, pa da svi ravnopravno ponude biračima proces decentralizacije. Ovako se stvara favorizacija ili partizacija, kako god da je nazovemo. Ali narod će zasigurno znati da odabere pravi glas i pravi izbor. Zahvaljujem! Ja sam samo kratko hteo da...

KRYETARI: Edhe deputeti i fundit për sot është Arben Gashi. Ke kujdes Arben, mos përmend emra!

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Po më duket se jam i fundit që drejtohem "i nderuar kryetar", nëse nuk ka ndonjë replikë prej dikujt tjetër.

Po më duket, që jam i fundit që po i drejtohem këtij Kuvendi dhe mbas diskutimeve që u mbajtën sot këtu, u panë shumë pasione, shumë dëshira, improvizime, deklarime. Prej deklarimeve se sa i keq është kryeministri, këtë e kemi ditur, deri te deklarimet se sa të

këqij janë opozita në krye me LDK-në, deri te kundërpërgjigjja se sa e keqe është “Vetëvendosja”, pastaj sa e keqe, hala më e keqe është AAK-ja...

Dhe, një laramani po ashtu, edhe ndërmjet grupeve parlamentare të komuniteteve. Krejt esenca e asaj çka jemi mbledhur këtu sot, nuk është të tregojmë se sa i keq është gjithsecili, as ta improvizojmë, ta sfidojmë njëri-tjetrin, “hajde tash, na ta bëjmë një mocion për ta rrëzuar Qeverinë”, ose “hajde tash, ne të merremi vesh, po e sfidojmë AAK-në dhe “Vetëvendosjen”, hajdeni ne të bëjmë koalicion dhe sigurt ta çojmë në opozitë PDK-në”, ose “hajde unë po tregoj se ne s’kemi asnjë lloj koalicioni me PDK-në dhe nuk do të kemi asnjë lloj koalicioni me PDK-në”...

Këto nuk kanë rëndësi sot, sot ka rëndësi një momentum, që po krijohet këtu. Po i jepet mundësia vendit për të shkuar në zgjedhje. Ato të tjerat janë pallavra, se a po e rrëzojmë Qeverinë, a po e rrëzojmë Kuvendin. E njëjta pasojë juridike dhe kushtetuese prodhohen.

Shpërndahet Kuvendi, Qeveria kthehet “Qeveri në detyrë”, shkohet në zgjedhje brenda 45 ditëve, jo më shpejt se 30 ditë, jo më vonë se 45 ditë. Kaq bëhet.

Të tjerat janë veç fjalë, reklamime personale e tjerë...

E dimë se sa të mirë e sa të këqij jemi gjithsecili prej nesh. Meqë e kisha rastin të jem i fundit, faleminderit, shihemi në legjislaturën tjetër.

KRYETARI: Ka shans dikush të jetë edhe për herë të fundit deputet.

Ju lutemi regjisë dhe deputetëve, që të votojmë për prezencë. Votojmë tash! Mirë, po presim edhe pak, por 100 veta janë bërë. A jeni të disponuar ju të votoni a mos të votoni? Regjia, i bini ziles edhe pak, se...

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se në bazë të nenit 82, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shpërndarja e Kuvendit bëhet me 2/3-at e gjithë deputetëve të Kuvendit. Pra, nevojiten së paku 80 vota të deputetëve për.

Me votim elektronik i kemi 115 deputetë, prania fizike 111.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

(Duartrokitje në sallë.)

Konstatoj se me 90 vota për, 4 kundër dhe 3 abstenime, Kuvendi vendosi për shpërndarjen e Legjislaturës së Katërt të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Mirupafshim pas zgjedhjeve!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*